



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.991/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Jeton Havolli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

#### **V E N D I M**

**Hudhet i palejuar** apeli Anr.991/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Jeton Havolli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.2948-2021, i datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021.

#### **A r s y e t i m**

PZAP-i, më datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.991/2021, i paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Jeton Havolli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, me të cilin kërkon që të bëhet rinumërimi i vendvotimeve 1810E/02D, 1810E/01R, 1812E/01R, 1812R/02R, 1812R/03R, 1812E/04D, 1815E/01R, 1815E/02D, 1841R/01R, 1841R/02D, 1803/01R, 1803E/02R, 1803E/03D, 1823R/01R dhe 1823E/02D për shkak se pretendon se në këto vendvotime e kanë votuar disa familjarë e që ato vota tani nuk i figurojnë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i palejuar**

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se apeli i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Podujevës Jeton Havolli nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Podujevës, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar nga Xhevdet Maloku kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Podujevës, të paraqitur me datën 04.11.2021 dhe është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, ndërsa shkeljet e pretenduara janë konsumuar me rastin e cekur më lartë.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.848/2021 të datës 05.11.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

**Anr.991/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.